



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 920/5 Prot.

Tiranë, më 30.12.2020

V E N D I M
Nr.230, dt. 30.12.2020

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 192, DATË 15.12.2020, TË
KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe Rregulloren “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

KONSTATOVA SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “*Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2018*”, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, përfshirë institucionin Instituti i Transportit në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Në kuadër të procesit të verifikimit, Komisioneri ka kërkuar informacion nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për institucionet në varësi, e cila ka raportuar nëpërmjet shkresës nr.4551/1 prot., datë 24.06.2020, se punonjësja ***** (datëlindja 28.09.1959), në pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Databazës së Transportit*”, e ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 28.09.2020.

Mbi këtë bazë, në zbatim të dispozitës ligjore të parashikuar nga germa c), e nenit 65, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Komisioneri, me Vendimin Paralajmërues nr. 192, datë 15.12.2020, ka vendosur:

“1. Të kërkoj nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Institutit të Transportit, marrjen e masave të menjëhershme për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, duke përfunduar

marrëdhënien në shërbimin civil për shkak të ligjit, si dhe pasqyrimin e akteve në Sistemin Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) për punonjësen e mëposhtme:

- ***** , në pozicionin e punës *“Përgjegjës i Sektorit të Databazës së Transportit”*.
- 2. Pozicioni respektiv i punës, të raportohet pranë Departamentit të Administratës Publike si pozicion i lirë dhe DAP të vijojë procesin për plotësimin e tij sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil.
- 3. Kryerja e veprimeve të mësipërme, duhet të bëhet brenda 7 ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim...”

Në vijim të zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin Paralajmërues nr. 192, datë 15.12.2020, të Komisionerit, institucioni Instituti i Transportit, përmes shkresës së dërguar me nr. 182/1 prot., datë 18.12.2020, protokolluar pranë Komisionerit me nr.920/4 prot., datë 21.12.2020, ka sqaruar se njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në Institutin e Transportit e ka pasqyruar vend vakant pozicionin *“Përgjegjës i Sektorit të Databazës së Transportit”*, në sistemin HRMIS. Njëkohësisht, në përmbajtjen e kësaj shkrese është kërkuar shtyrja e afatit të ndërprerjes së marrëdhënies së punësimit për punonjësen ***** deri në plotësimin e pozicionit të punës nga DAP nëpërmjet procedurave të konkurrimit për shkak të:

- pjesëmarrjes së saj në disa grupe pune dhe projekte të Komisionit Evropian;
- të formimit dhe përvojës së saj të gjatë dhe të pasur profesionale, punonjësja është e ngarkuar me disa detyra funksionale, ku ndër të tjera, punonjësja është pjesë e grupit të punës në projektin *“Për ngritjen e grupit të punës për identifikimin dhe kategorizimin e rrugëve Kombëtare”*, në zbatim të Urdhrit të Ministrit nr. 3056/3, datë 28.07.2016, si dhe në projektin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 661, datë 21.09.2016, për përditësimin e rrjetit rrugor të rrugëve të Njësive administrative, në hartën digjitale të Republikës së Shqipërisë si dhe në Gjeoportalin Kombëtar.

Në analizë të sa më lart kur, ndërprerja e menjëhershme e marrëdhënies së punës për punonjësen ***** , do të sillte pengesa në realizimin e këtyre projekteve si dhe do të krijonte pengesa në ecurinë normale të punës së institucionit Instituti i Transportit, vlerësoj se, kërkesa për shtyrjen e afatit për ekzekutimin e Vendimit Paralajmërues nr. 192, datë 15.12.2020, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Instituti i Transportit, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*, të Komisionerit, nga ana e institucionit Instituti i Transportit është e drejtë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, kreu IV “Rishikimi”, nenet 144, 145 dhe 146, si dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të ndryshoj pikën 3, të Vendimit nr. 192, datë 15.12.2020, me përmbajtje si më poshtë:

“3. Të vijojë marrëdhënia në shërbimin civil për punonjësen *****, me detyrë “Përgjegjës i Sektorit të Databazës së Transportit”, në Institutin e Transportit, deri në përfundimin e procedurës së rekrutimit për plotësimin e këtij pozicioni pune.”

2. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Instituti i Transportit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Departamenti i Administratës Publike dhe Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha